

Buletini i Financave Publike – Janar 2017

nga Instituti për Politikë Publike dhe Mirëqeverisjen

Ministria e Financave të Republikës së Shqipërisë publikoi Statistikat fiskale për muajin Janar 2017. Në shërbim të analizës janë përdorur të dhënat kumulative për të ardhurat publike, shpenzimet qeveritare dhe investimet nga Shkurti 1998 deri në Janar 2017.

Duke analizuar ecurinë e financave publike, Presidenti i Nderit të IPPM-së, Z. Arben Malaj, shprehet:

“Treguesit e muajit Janar 2017 tregojnë se, edhe pse të ardhurat shënuan një rritje prej vetëm 0.2% krahasuar me performancën e tyre me Janarin e vitit 2016, realizimi i shpenzimeve totale të buxhetit është rritur me 5.1%. Kjo rritje në shpenzimet totale i atribuohet kryesisht rritjes së shpenzimeve kapitale në krahasim me periudhën respektive të një viti më parë, në masën 26.9%. Ajo që vihet re është fakti se mbledhja e të ardhurave dhe realizimi i shpenzimeve për muajin Janar si përpjesë e planifikimit të të ardhurave dhe shpenzimeve të vitit 2017 ka qënë më e ulët për të dy komponentët krahasuar me mesataren e të njëjtit tregues përgjatë 10 viteve të fundit.”

Krahasimet kryesore:

Të ardhurat publike gjatë muajit Janar 2017 shënuan vlerën 32.894 miliardë lekë, një rritje prej 0.2% krahasuar me Janarin e vitit 2016 ose e shprehur në vlerë absolute me 65 milionë lekë.

Në muajin Janar, të ardhurat e realizuara ndaj të ardhurave totale të planifikuara në Buxhetin e vitit 2017 janë 7.538 % të totalit. Ndërsa po ti referohemi peshës mesatare për 10 vitet e fundit të të ardhurave të realizuara në muajin janar si pjesë e të ardhurave të vitit respektiv, ka qënë 7.723 %. Në këtë aspekt vihet re që janari i 2017 ka performuar më dobët sesa mesatarja e 10 viteve dhe më konkretisht duke shënuar një rënie prej 0.185 pikë përqindje.

Shpenzimet totale për këtë muaj arritën vlerën e 25.028 miliardë lekë, duke shënuar një rritje me 5.1 % krahasuar me shpenzimet totale të muajit Janar 2016 ose në vlerë absolute një rritje me 1,225 miliardë lekë.

Shpenzimet totale të realizuara në Janar 2017 ndaj shpenzimeve totale të planifikuara në Buxhetin e vitit 2017 janë 5.35 %, ndërsa pesha mesatare e shpenzimeve totale të realizuara gjatë 10 viteve të fundit për Janarin si pjesë e totalit të shpenzimeve të vitit respektiv ka qënë 5.64 %, duke shënuar një rënie prej 0.29 pikë përqindje.



Instituti për Politikë Publike dhe
Mirëqeverisjen

Web: www.ippm.al

E-mail: secretary@ippm.al

*për t'u bërë pjesë e listës
prioritare ju lutem na shkruani në
secretary@ippm.al*

Kryetar i Bordit:
Arlind Rama

Drejtor Ekzekutiv
Ledjon Shahini

Regjistruar ne Gjykatën e Tiranës,
Nr regjistrimi 389

Adresa: Rruga e Elbasanit Nr. 8,
Godina e KU Luarasi, Kati IV
Tiranë, Shqipëri

Investimet publike të muajit Janar shënuan vlerën 1.239 miliardë lekë, e barabartë kjo me 263 milionë lekë më shumë se shpenzimet kapitale të realizuara në Janar të një viti më parë, apo 26.9% më shumë.

Analizë e mëtejshme e treguesve

Mbi bazën e të dhënave zyrtare të statistikave fiskale të publikuara nga Ministria e Financave është përgatitur një analizë më e fokusuar e treguesve kryesorë të financave publike.

Të ardhurat në buxhetin e shtetit

Totali i të ardhurave në vlerë nominale për muajin Janar ka shënuar 32.894 miliardë lekë, ose 65 milionë më shumë se në Janar 2016. Rritja në të ardhurave në terma vjetore ka qënë në masën 0.2%. Kjo rritje e vogël ka ardhur kryesisht si pasojë e rënies së të ardhurave nga ndihmat në masën 44.5%, ndërkohë që të ardhurat tatimore janë rritur në masën 3.8% në krahasim me Janarin e 2016.

Sipas Indeksit të IPPM-së, në muajin Janar, të ardhurat e realizuara ndaj të ardhurave totale nga Buxheti 2017 janë 0.185 pikë përqindje më poshtë se pesha mesatare e të ardhurave të realizuara për muajin Janar gjatë 10 viteve të fundit.

Pesha e të ardhurave nga ndihmat për Janarin 2017 ndaj Buxhetit ishte 1.35 %, ndërsa mesatarja për 10 vitet e fundit ka qënë 3.42 %, duke bërë që pesha mesatare e këtij muaji për këtë kategori ë ardhurash të jetë 2.07 pikë përqindje nën mesataren e 10 vjeçarit.

Pesha e të ardhurave tatimore për Janarin 2017 ndaj Buxhetit 2017 ishte 7.77 %, ndërsa pesha mesatare e 10 vjeçarit të fundit për Janarin ka qënë 6.82 %, duke shënuar një përmirësim prej 0.95 pikë përqindje.

Shpenzimet totale

Gjatë muajit Janar 2017, shpenzimet totale kanë arritur vlerën 25.028 miliardë lekë, duke pësuar një rritje prej 1.225 miliardë lekë ose 5.1% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Shpenximet korrente janë rritur e 6.9% krahasuar me Janarin e vitit 2016, ku veçohet rritja e shpenzimeve operative për mirëmbajtje me 29.3% më shumë, rritja e shpenzimeve për buxhetin vendor me 27.8% dhe rritja e ndihmave ekonomike me 25,8%.



Instituti për Politikë Publike dhe
Mirëqeverisjen

Web: www.ippm.al

E-mail: secretary@ippm.al

*për t'u bërë pjesë e listës
prioritare ju lutem na shkruani në
secretary@ippm.al*

Kryetar i Bordit:
Arlind Rama

Drejtor Ekzekutiv
Ledjon Shahini

Regjistruar ne Gjykatën e Tiranës,
Nr regjistrimi 389

Adresa: Rruga e Elbasanit Nr. 8,
Godina e KU Luarasi, Kati IV
Tiranë, Shqipëri

Shpenzimet për interesat në Janar 2017 kanë pësuar rënie në masën 14.4% krahasuar me Janarin e 2016, ku vlen për t'u theksuar rënia e shpenzimeve për interesat e brendshme me 16.2% ose 403 milionë lekë në terma vjetorë.

Referuar Indeksit 10-vjeçar të IPPM-së për periudhën 2007-2016, rezulton se pesha e shpenzimeve totale të realizuara gjatë Janarit 2017 ndaj Buxhetit të këtij viti, është 0.29 pikë përqindje nën mesataren e shpenzimeve për Janarin të 10 viteve të fundit.

Pesha e shpenzimeve korrente të realizuara gjatë Janarit 2017 ndaj Buxhetit 2017 ishte 6.16 %, ndërsa pesha mesatare për këtë kategori shpenzimesh për 10 vitet e fundit për muajin Janar ka qenë 5.78 %, duke duke shënuar një përmirësim prej 0.38 pikë përqindje.

Investimet publike

Investimet publike gjatë Janarit të vitit 2017 arritën vlerën nominale 1.239 miliardë lekë duke shënuar një rritje prej 263 milionë lekë krahasuar me muajin Janar 2016, kjo e shprehur në terma relativë, 26.9% më shumë.

Financimi i brendshëm është rritur me 72 milionë lekë në krahasim me Janarin e vitit 2016, ose me 156.5% më shumë, ndërsa financimi i huaj është rritur me 191 milionë lekë ose me 20.5%.

Pesha e shpenzimeve kapitale të realizuar gjatë Janarit 2017 ndaj Buxhetit të këtij viti ishte 1.66 %, ndërsa pesha mesatare e shpenzimeve kapitale për 10 vitet e fundit për Janarin ka qenë 3.71 %.

Sipas Indeksit të IPPM-së, vlen për tu theksuar se pesha e investimeve publike të realizuara gjatë muajit Janar 2017 ndaj investimeve publike në Buxhetin 2017, është 2.05 pikë përqindje nën mesataren 10 vjeçare për muajin Janar.



Instituti për Politikë Publike dhe
Mirëqeverisjen

Web: www.ippm.al

E-mail: secretary@ippm.al

*për t'u bërë pjesë e listës
prioritare ju lutem na shkruani në
secretary@ippm.al*

Kryetar i Bordit:
Arlind Rama





Drejtor Ekzekutiv
Ledjon Shahini

Regjistruar ne Gjykatën e Tiranës,
Nr regjistrimi 389



Adresa: Rruga e Elbasanit Nr. 8,
Godina e KU Luarasi, Kati IV
Tiranë, Shqipëri

Analiza Grafike e Buletinit të Financave Publike- Janar 2017

1. Të ardhurat në Buxhetin e Shtetit




2. Shpenzimet Totale




Shpenzimet Mujore

Mil lekë




Pesha e shpenzimeve mujore




3. Investimet Publike

Investimet Publike dhe Indeksi i IPPM

Mil lekë




Pesha e shpenzimeve për investimet publike mujore dhe Pesha mesatare e 10 - vjeçarit




Investimet Publike Mujore

Mil lekë



Pesha e investimeve publike



FALEMINDERIT!

Për të marrë në kohë reale Buletinin e Financave Publike ju lutem na kontaktoni në secretary@ippm.al.

Informacione të mëtejshme në lidhje me analizën e përgatitur për Buletinin e Financave Publike mund të gjenden në:

Instituti për Politika Publike dhe Mirëqeverisje

www.ippm.al/buletiniifinancavepublike

Ministria e Financave, Statistikat mujore fiskale

www.minfin.gov.al